

VENDIM
Nr. 462, datë 10.6.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 599, DATË 31.8.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK,
TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I RRUGËS ‘DHIMITËR
KONOMI’, NË ZONËN E UJIT TË FTOHTË, VLORË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 599, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 3, shifra “27 776 834 (njëzet e shtatë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) lekë” ndryshon dhe bëhet “28 267 469 (njëzet e tetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë”.

b) Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 28 267 469 (njëzet e tetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet, si më poshtë vijon:

- 27 776 834 (njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) lekë, nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë;

- 490 635 (katërqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) lekë, nga buxheti i miratuar për Bashkinë Vlorë.”.

c) Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Shpenzimet procedurale të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.”.

ç) Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Nr.	Emër, mbiemër	Adresa	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale truall (m ²)	Sip. truall prekur	Çmimi truall (lekë/m ²)	Vlera e përgjithshme (lekë)	Gjendja juridike e pasurisë
46	Fotaq Konomi, Nikollaq Konomi	Vlorë	truall	8602	43/4/1	500	45	10,903	490,635	Konfirmuar nga ZVRPP-ja më datë 26.10.2018
Vlera e shpronësimit							45	10.903	490,635	